



EDUKIMI MJEDISOR



Dhjetor 2024

Edukimi mjedisor i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Ai është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë qarkulluese. Nxënësit përfshihen në mbrojtjen e natyrës dhe njëkohësisht e duan edhe më shumë atë.

“Edukimi mjedisor është mjeti më i fuqishëm që mund të përdorim për të ndryshuar botën”

Nelson Mandela

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në të 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjediseve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit



Përmes këtij manuali mujor **Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura** paraqet aktivitetet e zhvilluara nga **12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura**, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin dhe atyre që ndodhen pranë ZM-ve apo në zonat rurale, përgjatë muajit **dhjetor 2024**. Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të përfshirë **581**

Specialistë të angazhuar **26**

Orë mjedisore të realizuara **32**

32 Shkolla të përfshira

48 Mësues të përfshirë

“EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



11 dhjetor 2024, Dita Ndërkombëtare e Maleve

Administrata e Zonave të Mbrojtura Shkodër në bashkëpunim me GO2 Albania, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Maleve zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës së Mesme të Bashkuar “Nikë Mernaçaj”. Gjatë kësaj ore u diskutua për Parkun Kombëtar të Alpeve, rëndësinë e maleve dhe ruajtjen e tyre si një faktor kryesor për zhvillimin e qëndrueshëm. Për nxënësit u shfaq një përmbledhje dokumentarësh dhe filmash të realizuar në Kelmend nga Kinostudio “Shqipëria e Re”, e cila tregoi ndryshimet e mënyrës së jetesës dhe peizazhit malor përgjatë gjysmës së dytë të shekullit XX. Po ashtu, u pasqyruan 12 tabela informuese për Parkun Kombëtar të Alpeve në korridorin e kësaj shkolle në gjuhën shqipe dhe angleze.

19 dhjetor 2024, mbjellje fidanësh

Në kuadër të edukimit mjedisor specialistët e AdZM Shkodër, realizuan një aktivitet mjedisor të rëndësishëm në Malin e Taraboshit, pjesë e Rezervatit Natyror të Menaxhuar “Liqeni i Shkodrës”. Aktiviteti kishte për qëllim mbjelljen e 150 fidanëve të llojit Pishë e Egër (Pinus nigra), një hap i rëndësishëm për ruajtjen e biodiversitetit dhe forcimin e ekosistemit të zonës malore. Në këtë aktivitet u angazhuan aktivistët e The Door Albania, dhe me një kontribut të veçantë nxënësit dhe mësuesit e shkollave “Prenkë Jakova” dhe “Kolë Margjini”. Nxënësit dhe mësuesit e shkollave “Prenkë Jakova” dhe “Kolë Margjini” jo vetëm që kontribuan në mbjelljen e pemëve, por gjithashtu përfituan nga mundësia për të mësuar rreth rëndësisë së ruajtjes së mjedisit dhe biodiversitetit të zonës.



“EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS



toka e shëndetshme

edukim mjedisor



5 dhjetor 2024, Dita Botërore e Dheut

Stafi i AdZM-së Kukës, në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare "Gostil" Kukës, zhvilloi një aktivitet mjedisor jashtë ambienteve të shkollës, me rastin e Ditës Botërore të Dheut. Ky aktivitet kishte për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit tek nxënësit për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe përkujdesjen ndaj natyrës. Nxënësit u njohën me vlerat natyrore të planetit tonë dhe me rolin e secilit prej nesh në ruajtjen e tij. Aktiviteti shërbeu si një mundësi për të diskutuar se si veprimet e përditshme të individëve ndikojnë në mjedisin dhe si mund të kontribuojmë për të mbajtur mjedisin të pastër dhe të shëndetshëm.

11 dhjetor 2024, Dita Ndërkombëtare e Maleve

Në kuadër të edukimit mjedisor dhe Ditës Ndërkombëtare të Maleve, stafi i AdZM Kukës organizoi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Ali Podrimja". Gjatë kësaj ore, nxënësit u njohën me majat më të larta të Parkut Kombëtar të Alpeve Shqiptare, rëndësinë e tyre për biodiversitetin e parkut, si dhe ndikimin e mundshëm në zhvillimin e turizmit në këtë zonë. Mesazhi kryesor që u përçua tek nxënësit ishte ndërgjegjësimi për vlerat e maleve, rëndësinë e kujdesit ndaj tyre dhe nevoja për promovimin e këtyre pasurive natyrore.

11 dhjetor 2024, orë mjedisore

Si pjesë e edukimit mjedisor dhe me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Maleve, stafi i AdZM Kukës organizoi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Zapod". Gjatë këtij aktiviteti, nxënësit u njohën me majat më të larta të Parkut Natyror "Korab-Koritnik" dhe vlerat që mbartin malet e kësaj zone, rëndësinë e ruajtjes së tyre dhe nevojën për t'i promovuar ato.

23 dhjetor 2024, aktivitet mjedisor

Stafi i AdZM Kukës zhvilloi një orë mjedisore në shkollën e Mesme e Bashkuar "Bushtricë", me qëllim që nxënësit të njohin më thellë rëndësinë dhe statusin e AdZM Kukës në ruajtjen e mjedisit dhe menaxhimin e burimeve natyrore. Aktiviteti synonte ndërgjegjësimin e nxënësve për rolin e këtij institucioni në mbrojtjen e biodiversitetit dhe përmirësimin e kushteve mjedisore. Pas kësaj ore mjedisore, në bashkëpunim me nxënësit, AdZM Kukës realizoi një aktivitet pyllëzimi, duke mbjellë 100 fidanë të llojit pishë e zezë në ambientet e jashtëm të shkollës. Ky aktivitet kishte për qëllim të inkurajonte nxënësit për të kontribuar në ruajtjen e mjedisit dhe për të gjelbëruar mjediset e përbashkëta për brezat e ardhshëm.



11 dhjetor 2024, Dita Ndërkombëtare e Maleve

Administrata e Zonave të Mbrojtura Dibër, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Maleve realizoi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës së Mesme të Bashkuar "Gjergj Kastrioti", Baz. Gjatë kësaj orë mjedisore, nxënësit u njohën më nga afër me rëndësinë e maleve dhe ekosistemet që ato mbartin. Me anë të vizatimeve, nxënësit arritën të kuptojnë më shumë mbi struktura të ndryshme të maleve dhe rolin e tyre në mjedis. Aktiviteti u zhvillua me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit tek fëmijët për mbrojtjen dhe ruajtjen e maleve si pjesë e rëndësishme e natyrës dhe mjedisit tonë.



5 dhjetor 2024, mbjellje fidanësh

Në kuadër të Ditës Botërore të Dheut, specialistët e AdZM Durrës organizuan një orë mjedisore në shkollën 9- vjeçare “Pren Simoni” Draç. Në këtë aktivitet morën pjesë nxënës të klasës së 7-të. Dita Botërore e Dheut ka për qëllim të inkurajojë nxënësit të angazhohen në përmirësimin e shëndetit të tokës. Gjatë aktiviteti u theksua se kur dheu nuk trajtohet siç duhet, mund të humbasë aftësinë për të mbajtur ujë dhe ushqyes, duke shkaktuar erozion. Në fazën e dytë, nxënësit u njohën me procesin e përpunimit dhe plehërimit të tokës dhe më pas, mbollën 30 fidanë lejland, pishë të butë dhe ullinj. Aktiviteti synonte të përçonte mesazhin se kjo ditë është një mundësi për të mësuar rreth sfidave ekologjike dhe për të marrë pjesë në aktivitete që përmirësojnë mjedisin, si mbjellja e pemëve dhe pastrimi i mbetjeve.

11 dhjetor 2024, Dita Ndërkombëtare e Maleve

Në Shkollën 9-vjeçare "Selman Ali Xaka", klasa e 5-të dhe e 6-të së bashku me specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore për Ditën Ndërkombëtare të Maleve. Fillimisht nxënësit diskutuan mbi rëndësinë e maleve, mësuan për 10 malet më të larta në Shqipëri dhe u njohën me pikën më të lartë në Parkun Kombëtar "Qafështamë". Aktiviteti theksoi rolin e maleve si burim i rëndësishëm për ekosistemet, ujë të pijshëm, strehim për florën dhe faunën, si dhe mbështetje për zhvillimin ekonomik të komuniteteve. Më pas, nxënësit morën pjesë në një aktivitet krijues ku improvizuan male me materiale të ndryshme dhe, për të mbyllur aktivitetin, mbollën 30 fidanë të llojit pishë e egër në ambientet e shkollës.

18 dhjetor 2024, funksioni i pyjeve në ekosistem

Specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare "Arbëria" në Halil. Tema e aktivitetit ishte "Rëndësia dhe funksioni i pyjeve në ekosistem". Aktiviteti filloi me një sesion informues ku nxënësit mësuan për rolin e pazëvendësueshëm të pyjeve në ekosisteme, përfshirë prodhimin e oksigjenit, ruajtjen e biodiversitetit, rregullimin e klimës dhe parandalimin e erozionit të tokës. Ata mësuan gjithashtu se pyjet janë burim i ujit të pastër dhe ofrojnë materiale të ndryshme që mbështesin ekonominë dhe jetesën e komuniteteve. Gjatë kësaj ore mjedisore, nxënësve iu shpërndanë pyetësorë lidhur me temën, të cilat ata i plotësuan dhe më pas diskutuan së bashku përgjigjet. Ruajtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve është jetik për mirëqenien e planetit dhe mbrojtjen e ekosistemit global. Ky ishte dhe mesazhi i cili u përcoll nga specialistët e AdZM Durrës




5 dhjetor 2024, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Tiranë në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare "Zenel Bastari" në fshatin Bastar i Mesëm zhvilluan një orë mjedisore në kuadër të Ditës Botërore të Dheut. Aktiviteti i zhvilluar me nxënësit e klasës së 8-të ishte një mundësi e shkëlqyer për të ndihmuar të rinjtë të kuptojnë rëndësinë e shtresave të dheut dhe ndikimin që kanë ato në jetën dhe ekosistemet natyrore. Ky aktivitet kishte një strukturë të organizuar mirë dhe përfshinte mësimin aktiv, krijimtarinë dhe përfshirje të drejtpërdrejtë nga ana e nxënësve. Për të thelluar njohuritë e fituara, ata plotësuan një pyetësor dhe u ndanë në grupe për të realizuar makete që pasqyronin shtresat e dheut. Në fund të aktivitetit, nxënësit mbollën fara në vazo me dhe, duke simbolizuar angazhimin e tyre për ruajtjen e mjedisit.

11 dhjetor 2024, Dita Ndërkombëtare e Maleve,

AdZM Tiranë përfaqësuar nga specialistët, zhvilloi në Shkollën e Mesme të Bashkuar "Bahri Nela", një aktivitet me nxënësit e klasës së 6-të i cili kishte për temë Ditën Ndërkombëtare të Maleve. Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me rëndësinë e maleve për mjedisin, biodiversitetin dhe jetën e përditshme të njerëzve. Ata krijuan një poster informues dhe dy makete që ilustronin karakteristikat e maleve. Aktiviteti theksoi rëndësinë e edukimit të brezave të rinj për ruajtjen dhe përkujdesin ndaj maleve. Rritja e informimit dhe edukimit të brezave të rinj për rëndësinë, ruajtjen dhe përkujdesin ndaj maleve është një hap i domosdoshëm për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme për planetin tonë.



17 dhjetor 2024, aktivitet krijues

Nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Hasan Tahsin” Tiranë, mirëpritën specialistët e AdZM Tiranë për të realizuar një orë mjedisore dedikuar krijimtarisë me anë të materialeve natyrore. Aktiviteti u fokusua në krijimin e një peme festive ku nxënësit përdorën degë të thata, boçe pishe dhe bimën e njohur si ashja, e cila është simbol i krishtlindjeve. Gjithashtu nxënësit krijuan kartolina unike me plot ngjyra, duke përcjell frymën festive dhe rëndësinë e ruajtjes së mjedisit.

20 dhjetor 2024, njohja me pishat dhe bredhat

Një orë mjedisore u zhvillua në ambientet e kubit InNature nga specialistët e AdZM Tiranë me temë “Krijimi dhe Dekorimi i Bredhave të Festivë”. Në këtë aktivitet morën pjesë fëmijë të grupmoshave 7-11 vjeç. Fëmijët u njohën me llojet e bredhave në Shqipëri, karakteristikat e tyre dhe rëndësinë për mjedisin. Aktiviteti solli një mundësi për fëmijët të shprehin krijimtarinë e tyre dhe të kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit, duke i ndihmuar ata të kuptojnë si mund të përdoren materialet natyrore për të krijuar produkte të bukura. Bredhat e dekoruara dhe dekorimet shumëngjyrëshe që ata krijuan ishin një dhuratë festive për veten dhe një mësim mbi rëndësinë e natyrës dhe mbrojtjen e mjedisit.



5 dhjetor 2024, Dita Botërore e Dheut

Specialistët e AdZM Elbasan, së bashku me nxënësit e shkollës së Mesme të Bashkuar "Isak Alla", realizuan një orë mjedisore në kuadër të "Ditës Botërore të Dheut", ditë në të cilën vëmendja kthehet drejt natyrës dhe shtimit të hapësirave të gjelbra si një formë ndërgjegjësimi për mbrojtjen dhe kujdesin që duhet të tregojmë ndaj tokës, nga e cila nis gjithçka. Gjatë kësaj ore nxënësit u njohën me rëndësinë e tokës dhe dheut si një faktor i rëndësishëm për sigurinë e ushqimit, ekosistemet e shëndetshme dhe mirëqenies njerëzore. Së bashku me nxënësit, u demonstrua mbjellja e disa farërave të ndryshme, duke krijuar kështu një kopësht të vogël në klasë. Ky mini-projekt kishte si qëllim të ndiqte zhvillimin e farërave dhe të shihte rezultatet e mbjelljes, të cilat mund të mbillen më vonë në ambientet e shkollës ose rreth saj. Aktiviteti ndihmoi nxënësit të kuptojnë më mirë rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe ndikimin që kanë veprimet e tyre në ruajtjen e dheut.

11 dhjetor 2024, mbjellje fidanesh

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Maleve, AdZM Elbasan dhe Alb Natyra në bashkëpunim me shkollat 9-vjeçare "Genc Leka" "Vilson Blloshmi" dhe Kryetarin e Bashkisë Librazhd, organizuan një aktivitet të suksesshëm për mbjelljen e 300 fidanëve të pishës së zezë, lisit dhe bredhit në Parkun Kombëtar "Shebenik", në zonën e njohur si Qafë-Shul. Ky aktivitet kishte qëllim pasurimin e florës së zonës, por edhe ngritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe përfshirjen aktive të komunitetit, veçanërisht të rinjve, në ruajtjen dhe përmirësimin e habitateve natyrore. Pjesëmarrësit duke përfshirë nxënësit dhe mësuesit, u angazhuan aktivisht në mbjelljen e fidanëve dhe mësuan mbi rëndësinë e mbrojtjes së tokës dhe rigjenerimit të florës. Ky angazhim u pasua nga një fushatë ndërgjegjësimi mbi mbrojtjen e biodiversitetit dhe rëndësinë e ruajtjes së maleve si pjesë të rëndësishme të mjedisit. Aktivitete të tilla ndihmojnë në forcimin e marrëdhënieve midis shkollave, komunitetit dhe autoriteteve lokale në përpjekjet për mbrojtjen e mjedisit.

17 dhjetor 2024, aktivitet mjedisor

Specialistët e AdZM Elbasan realizuan një aktivitet mjedisor me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Funarës". Në ambientet e jashtme të shkollës nën kujdesin dhe udhëheqjen e specialistëve, nxënësit mbollën disa fidanët të llojit dushk, pishë e zezë dhe dafinë. Gjatë këtij aktiviteti ata u njohën me vlerat natyrore dhe mjedisore të Parkut Kombëtar "Shebenik", duke marrë informacion mbi destinacionet turistike të tij. Pas orës mjedisore, së bashku me nxënësit vijuan me mbjelljen e fidanëve në ambientet rreth shkollës, ku ata mësuan mbi rëndësinë e shtimit të hapësirave të gjelbërta, kujdesin ndaj natyrës si një pjesë shumë e rëndësishme, e cila ndikon në cilësinë e ajrit që ne marrim çdo ditë dhe të jetuarit shëndetshëm.

“EDUKIMI MJEDISOR”, FIER



5 dhjetor 2024, orë mjedisore

AdZM Fier organizoi një orë mjedisore në Qendrën e Vizitorëve me studentët e Fakultetit të Shkencave Pyjore të Universitetit Bujaësor të Tiranës. Aktiviteti filloi me njohjen e studentëve me organizimin e administratës dhe rolin e saj si njësi menaxhuese e zonave të mbrojtura. Pas kësaj, ata u njohën me vlerat natyrore të Parkut Kombëtar “Divjakë-Karavasta”, si dhe habitatet natyrore që kjo zonë mbart, duke përfshirë ekonominë pyjore të Pishës së Divjakës, dunat dhe lagunën. Gjithashtu studentët zhvilluan edhe një aktivitet vëzhgimi të shpendëve. Si pjesë e kontributit të tyre për natyrën, ata mbollën disa fidanë pishe të butë.

12 dhjetor 2024, mbjellje fidanesh

Specialistët e AdZM Fier, në bashkëpunim me Eco-Albania, realizuan një aktivitet mbjelljeje me nxënës të shkollës së mesme “Fier -Seman”. Aktiviteti nisi me një prezantim mbi Parkun Kombëtar “Divjakë-Karavasta”, ku nxënësit u njohën me rëndësinë e këtij parku dhe vlerat natyrore që parku ka. Më pas, u shpjegua teknika e saktë e mbjelljes së fidanëve të pishës. Gjatë aktivitetit, nxënësit mbollën gjithsej 700 fidanë pishe, duke kontribuar në ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit të zonës.



16 dhjetor 2024, sesion informues

Studentët e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit zhvilluan një sesion informues të organizuar nga specialistët e AdZM Fier në Parkun Kombëtar “Divjakë-Karavasta”.

Ky aktivitet i dha mundësinë studentëve të zhvillojnë aftësi praktike dhe të fitojnë njohuri të vlefshme për menaxhimin dhe mbrojtjen e mjedisit, duke u fokusuar në ekosistemet dhe pasuritë natyrore të Parkut Kombëtar “Divjakë-Karavasta”. Pjesëmarrësit patën mundësinë të shohin nga afër sfidat dhe mundësitë që lidhen me menaxhimin e këtyre pasurive dhe të kuptojnë më mirë si ndihmon ruajtja e mjedisit në zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe ekosistemeve natyrore.

21 dhjetor 2024, aktivitet mjedisor

Në kuadër të studimit për sekuestrimin e karbonit në ligatinat bregdetare të Shqipërisë, stafi akademik i Universitetit Bujqësor të Tiranës, në bashkëpunim me atë të Administratës së Zonave të Mbrojtura të Qarkut të Fierit, ka realizuar marrjen e mostrave të tokës në zonën e Lagunës së Karavastasë. Ky studim ka si qëllim analizimin e kapacitetit të sekuestrimit dhe depozitimit natyror të karbonit, si dhe vlerësimin e ndikimit të kësaj zone në reduktimin e gazeve serë.



11 dhjetor, 2024 orë mjedisore

Specialistët e AdZM Lezhë organizuan një aktivitet edukativ mjedisor me nxënësit e klasës së 5-të shkollës 9-vjeçare “Besëlidhja” për Ditën Ndërkombëtare të Maleve. Aktiviteti nisi me një prezantim të shkurtër mbi malet dhe zonat e mbrojtura, duke përfshirë karakteristikat e tyre. Më pas, fëmijët morën pjesë në një aktivitet krijues dhe argëtues gjatë të cilit krijuan male prej letrash duke përdorur metoda të thjeshta dhe praktike për ta.

12 dhjetor 2024, njohja me Lagunën e Patokut

Dita e Lagunës së Patokut, shënon një mundësi të shkëlqyer për të rritur ndërgjegjësimin për këtë mjedis të pasur natyror. Stafi i AdZM Lezhë organizoi një aktivitet edukativ me nxënësit e shkollës “Ndoc Gjetja”, ku ata u njohën më nga afër me rëndësinë ekologjike të lagunës. Fëmijët mësuan për florën e lagunës, duke u njohur me bimët dhe shtresat e ndryshme të vegjetacionit që mbajnë ekosistemin në jetë. Po ashtu, ata u informuan për faunën e pasur të lagunës, përfshirë shpendët dhe kafshët që e banojnë këtë hapësirë, duke theksuar rolin e saj si habitat jetik për shumë lloje të rrezikuara. Aktiviteti përfundojë me pyetësorë dhe diskutime për të thelluar njohuritë mbi rëndësinë e ruajtjes së këtij mjedisi natyror.

“EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇË



4 dhjetor 2024, orë mjedisore

Nxënësit e klasës së 4-të të shkollës “Mësonjëtorja e Parë Shqipe” morën pjesë në një aktivitet edukues të organizuar nga specialistët e AdZM Korçës, që kishte në fokus Parkun Kombëtar të Prespës dhe biodiversitetin e tij. Ata u njohën me këtë zonë të mbrojtur dhe speciet e veçanta që jetojnë aty. Gjatë aktivitetit, nxënësit morën informacion mbi rëndësinë e ruajtjes së natyrës dhe kontributin që mund të japin. Pjesë e aktivitetit ishte edhe një pyetësor, që i ndihmoi ata të përforcojnë njohuritë e fituara në mënyrë argëtuese.



informim

ndërgjegjësim

mbjellje

pyllëzim

17 dhjetor 2024, rëndësia e mbjelljeve

Në shkollën "Muharrem Çollaku" në Pogradec, nxënësit e klasave të 12-ta morën pjesë në një orë mjedisore të organizuar nga AdZM Korçë, ku u informuan për nisjen e sezonit të mbjelljeve. Gjatë aktivitetit, nxënësit mbollën 50 fidanë gështenjë në peizazhin e mbrojtur të Liqenit të Pogradecit. Aktiviteti kishte për qëllim edukimin e nxënësve për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit dhe inkurajimin e mbjelljes së pemëve çdo vit, si dhe ndërgjegjësimin për pasojat e prerjes së pemëve. Mesazhi kryesor i aktivitetit ishte që të mbrojmë natyrën dhe të kontribuojmë në mbrojtjen e mjedisit.

18 dhjetor 2024, pyllëzimi dhe mbrojtja e natyrës

Specialistët e AdZM Korçë zhvilluan një orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare "Mustafa Jashari" në Mollas të Kolonjës, me temën "Pyllëzimi dhe mbrojtja e natyrës". Gjatë këtij aktiviteti, u theksua rëndësia e aksioneve të pyllëzimit dhe ruajtjes së natyrës për përmirësimin e mjedisit dhe mbrojtjen e ekosistemeve. Nxënësit morën pjesë në mbjelljen e disa fidanëve të llojit gështenjë pranë oborrit të shkollës. Ata gjithashtu u angazhuan që të kujdesen për fidanët e mbjellë, duke u bërë pjesë e një iniciative për ruajtjen dhe pasurimin e natyrës në zonën e Kolonjës. Aktiviteti synonte të edukonte nxënësit për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe kontributin e tyre në ruajtjen e tij.

19 dhjetor 2024, orë mjedisore

Nxënësit e shkollës "Ismail Gjata" në Cangonj morën pjesë në një orë mjedisore nga specialistët e AdZM Korçë, ku u mbollën 10 fidanë bli në oborrin e shkollës. Aktiviteti i organizuar kishte për qëllim sensibilizimin e nxënësve për rëndësinë e mbrojtjes së natyrës dhe ruajtjen e mjedisit.



11 dhjetor 2024, karakteristikat e parqeve

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Maleve, specialistët e AdZM Berat organizuan një orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare "1 Maji" me fokus njohjen e parqeve kombëtare të Shqipërisë. Gjatë kësaj ore nxënësit u njohën me karakteristikat dhe vendndodhjen e këtyre parqeve, duke përdorur hartën e Shqipërisë për të gjetur saktësisht vendodhjen e tyre. Aktiviteti kishte për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor dhe inkurajimin e nxënësve për të kuptuar rëndësinë e ruajtjes së natyrës dhe biodiversitetit.

njohja e parqeve kombëtare

biodiversitet

mjedis natyror

“EDUKIMI MJEDISOR”, GJIROKASTËR



3 dhjetor, informim

AdZM Gjirokastrë ka realizuar një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Frymë dashurie”, me qëllim informimin për zonat e mbrojtura duke u fokusuar dhe në pasuritë natyrore të Parkut Kombëtar “Bredhi i Hotovës-Dangëlli”. Kjo iniciativë synon rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e mbrojtjes së natyrës dhe promovimin e vlerave ekologjike.

5 dhjetor 2024, orë mjedisore

Në Ditën Botërore të Dheut, AdZM Gjirokastrë zhvilloi një orë mjedisore me klasën e 4-të të shkollës “Kamber Bënja”. Gjatë kësaj ore, u realizua një eksperiment praktik ku dheu u përzie me ujë dhe detergjentë dhe u la për 24 orë në një enë qelqi. Nxënësit përsëritën procesin në klasë për të demonstruar rezultatet, duke shpjeguar shtresat e krijuara nga argjila dhe rëra. Në fund, ata përcaktuan llojet e dheut bazuar në piramidën e strukturës së tij. Qëllimi i kësaj ore ishte edukimi i nxënësve për rëndësinë e tokës dhe zgjerimi i njohurive të tyre mbi karakteristikat e dheut.



18 dhjetor 2024, sesion informues

Specialistët e AdZM Vlorë zhvilluan një sesion informues me studentët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Studentët u informuan mbi protokollet e monitorimit të cilësisë së ujërave në zonat e mbrojtura. Ato u njohën me proceset dhe parametrat kryesorë që përdoren për të vlerësuar cilësinë e ujit.